XI. Dokumentacioni ndërtimor - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", "Rregullores mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi", të MMPH nr. 0/2016 dt. 04.11.2016, "Udhëzimit Administrativ MMPH-së 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor", bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;
- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobilianin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kycje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kycje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kycje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;

XII. Dokumentacioni ndërtimor për Masat e mbrojtëse nga zjarri të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të



procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarr. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni ndërtimor për Leje Mjedisore Komunale të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raportin për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3)kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;

Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

**XIII. Marrëveshja për Infrastrukturë** – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të ri-mbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin / investitorin.

Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkë investim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve (bashkëpronarëve të parcelave & investitorit);

**XIV. Paga e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore** - meqenëse parcelat kadastrale nr.10330-2, 1949-11 & 10197-4 ZK Prishtinë, në bazë të certifikatave të njësisë kadastrale, evidentohen me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit "Arë e klasit të 5", dhe Infrastrukturë – "Rrugë", paraprakisht kërkohet të bëhet paga e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konformë nenit 11, 13 & 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 & 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, gjegjësisht parcelës ndërtimore përcaktuar sipas Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej  $S=7624 + 465 + 37=8126m^2$ . Kjo sipërfaqe së bashku, do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,



Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

**XV. Pagesa e taksës administrative dhe tarifës** për dhënien e lejes së ndërtimit, do të realizohet bazuar në "Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

Pagesa e taksës administrative do të llogaritet edhe për rrënimin e ndërtimeve ekzistuese në kuadër të parcelës kadastrale, bazuar në gjendjen ekzistuese, incizimin gjeodezik dhe projektin ideor të atyre ndërtimeve, me pagesën e taksës së përcaktuar në pikën 5.9 të nenit 5 të rregullores së lartcekur dhe vendimit për lejimin e rrënit.

**XVI. Kushti** i përcaktuar në paragrafët, VI. /Këmbimi/, VII./Ndërrimi - shkëmbimi/ & VIII. /Bashkimi/ të vendimit të kushteve ndërtimore, do të jenë të domosdoshme për realizimin e Faza "2" të kompleksit, gjegjësisht Ndërtesën "D" të kompleksit.

Para realizimit të kushteve të lartë cekura, mund të realizohet Faza "1" me Ndërtesat "A", "B", "C" & "D";

**XVII. Vlefshmëria** e vendimit të kushteve ndërtimore është një(1) vit, me mundësi të vazhdimi për një(1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

## Arsyetim

Kërkesit / bashkëpronarët, Arben Hasani nga Ferizaji, Agim Çavota, Rexhep Limani, Halit Beqa, Sabri Tërnavë, Bekim Zeqiri, Idriz Ferati, Lindita Jusufi, Ismet Maloku, Islam Rushiti, Hamide dhe Ymrije Rama, Sabri dhe Hilmi Hajdini nga Prishtina dhe Investitorit "Alwera Invest" sh.p.k. nga Ferizaj, me certifikatë të biznesit 81127999 dhe pronar Arben Hasani nga Ferizaj, me kërkesës 05nr.350/03 -147909/19 dt.27.06.2019, kanë kërkuar kushte ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e **Kompleksi "Alwera"** me ndërtesa shumë banesore & afariste – **Ndërtesa, "A", "B", "C" & "D"**, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

Me kërkesën, 05nr.350/03 -147909/19 dt.27.06.2019, për kushte ndërtimore, dhe plotësuar me shkresa, "Pezullim i procedurës" 05nr.350/02 – 147909/19/1 dt.15.08.2019 dhe shkresat "Plotësim dokumentacioni" 05nr.350/02 – 147909/19/1 dt.09.03.2020 05nr.350/02 – 147909/19/1 dt.02.07.2020, si dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës, është prezantuar dokumentacioni dhe prëvat si në vijim:

- *Dëshminë mbi pronësinë: Kopjen e planit dhe Certifikatat e njërive kadastrale për parcelat kadastrale nr. 1802-5, 1802-3, 1802-2, 1802-14, 1802-11 ZK Prishtinë, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër e Komunës së Prishtinës;*
- *Dëshmia mbi pronësinë: Kopjen e planit dhe certifikatën e parcelës kadastrale nr.10330-2, 10330-1, 10330-3, 10330-5 & 10330-4 ZK Prishtinë, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër e Komunës së Prishtinës;*
- *Dëshmia mbi pronësinë: Kopjen e planit dhe certifikatën e parcelës kadastrale nr.284-2 & 284-1 ZK Çagllavicë, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër e Komunës së Prishtinës;*
- *Projekt propozimin konceptual të Kompleksi "Alwera" me ndërtesa shumë banesore & afariste – Ndërtesat, "A", "B", "C" & "D", hartuar nga N.P.N "Green Door" nga Prishtina me certifikatë ARBK 810512716, me projektues Driton Tefiku;*
- *Vendimit mbi pezullimin e procedurës administrative 05nr.350/02 – 147909/19/1 dt.19.08.2019, lëshuar nga kjo drejtori;*
- *Shkresat "Ftesë" të datës 27.02.2020, dërguar Nehat Rexhepaj nga Prishtina dhe Raif Morina nga Prishtina;*
- *Procesverbali i datës 26.02.2020, përpiluar në zyrat e drejtorisë;*
- *Procesverbal i datës 26.03.2020, përpiluar në zyrat e drejtorisë;*



- Shkresa "Njoftimi publik" të datës 04.07.2019 dhe 19.07.2019; lëshuar nga kjo drejtori;
- Manuali i ndarjes dhe bashkimit të parcelave kadastrale, punuar nga Roland Merxha nga Prishtina me licencë 167;
- Vërtetimi i obliguesit tatimor "Alvera invest" nga Ferizaji me nr.146703-19 dt.24.06.2019;
- Vërtetimi i obliguesit tatimor Agim Çavota nga Prishtina me nr.146703-19 dt.24.06.2019;
- Vërtetimi i obliguesit tatimor Ism,et Maloku nga Prishtina me nr.146703-19 dt.24.06.2019;
- Vërtetimi i obliguesit tatimor Islam Rushiti nga Prishtina me nr.146703-19 dt.24.06.2019;
- Vërtetimi i obliguesit tatimor Hamide Rama nga Prishtina me nr.146703-19 dt.24.06.2019;
- Vërtetimi i obliguesit tatimor Ymrane Halit Rama nga Prishtina me nr.146703-19 dt.24.06.2019;
- Vërtetimi i obliguesit tatimor Halit Beqa nga Prishtina me nr.146703-19 dt.24.06.2019;
- Vërtetimi i obliguesit tatimor Ramize Selimi nga Prishtina me nr.146703-19 dt.24.06.2019;
- Vërtetimi i obliguesit tatimor Bekim Zeqiri nga Prishtina me nr.146703-19 dt.24.06.2019;
- Vërtetimi i obliguesit tatimor Sabri Trnava nga Prishtina me nr.146703-19 dt.24.06.2019;
- Vërtetimi i obliguesit tatimor Idriz Ferat nga Prishtina me nr.146703-19 dt.24.06.2019;
- Vërtetimi i obliguesit tatimor Lendita Bekteshi nga Prishtina me nr.146703-19 dt.24.06.2019;
- Certifikata e biznesit të "Alvera Invest"sh.p.k nga Ferizaji, me ARBK 811271999;
- Fotokopja e letërnjoftimeve të pronarëve dhe investitorit;
- Akti noterial "Kontratë mbi ndërtimin e përbashkët të objektit banesor-afarist", e lidhur në mes Ismet Maloku, Naile Maloku dhe Investitorit "Alvera Invest sh.p.k. nga Ferizaji, përpiluar te Noterë Valbona Murtezi Bytyqi me LRP.nr.1747/2019 dhe Ref.nr.890/2019 dt.14.05.2019;
- Akti noterial "Kontratë mbi ndërtimin e përbashkët të objektit banesor-afarist", e lidhur në mes Idriz Ferati, Bekim Zeqiri, Lindita Beqiri, Halit Beqa, Sabri Trnava dhe Investitorit "Alvera Invest sh.p.k. nga Ferizaji, përpiluar te Noterë Valbona Murtezi Bytyqi me LRP.nr.818/2019 dhe Ref.nr.443/2019 dt.08.03.2019;
- Akti noterial "Kontratë mbi ndërtimin e përbashkët të objektit banesor-afarist", e lidhur në mes Agim Çavota, Zarife Çavota dhe Investitorit "Alvera Invest sh.p.k. nga Ferizaji, përpiluar te Noterë Valbona Murtezi Bytyqi me LRP.nr.628/2019 dhe Ref.nr.346/2019 dt.25.02.2019;
- Akti noterial "Kontratë mbi ndërtimin e përbashkët të objektit banesor-afarist", e lidhur në mes Hamide Rama, Bukurije Hajdari, Remzije Selimi dhe Investitorit "Alvera Invest sh.p.k. nga Ferizaji, përpiluar te Noterë Valbona Murtezi Bytyqi me LRP.nr.1177/2019 dhe Ref.nr.620/2019 dt.02.04.2019;
- Akti noterial "Kontratë mbi ndërtimin e përbashkët të objektit banesor-afarist", e lidhur në mes Ymirje Rama dhe Investitorit "Alvera Invest sh.p.k. nga Ferizaji, përpiluar te Noterë Valbona Murtezi Bytyqi me LRP.nr.1819/2019 dhe Ref.nr.930/2019 dt.20.05.2019;
- Akti noterial "Kontratë mbi ndërtimin e përbashkët të objektit banesor-afarist", e lidhur në mes Islam Rushiti dhe Investitorit "Alvera Invest sh.p.k. nga Ferizaji, përpiluar te Noterë Valbona Murtezi Bytyqi me LRP.nr.1613/2019 dhe Ref.nr.810/2019 dt.03.05.2019;
- Situacionin e terrenit për parcelat kadastrale, punuar nga gjeodeti i licencuar Faton Bajselmani nga Prizreni me licencë nr.125;
- Fotot e lokacionit;
- Manualin e ndarjes dhe bashkimit të parcelave kadastrale nr.1949-11 ZK Prishtinë, punuar nga gjeodeti i licencuar Roland Merxha nga Peja me nr. të licencës 167;

Drejtorja e Urbanizmit, pas shqyrtimit të kërkesës për caktimin e kushteve ndërtimore, 05nr.350/03 -147909/19 dt.27.06.2019, dhe plotësuar me shkresat: "Pezullim i procedurës" 05nr.350/02 – 147909/19/1 dt.15.08.2019, "Plotësim dokumentacioni" 05nr.350/02 – 147909/19/1 dt.09.03.2020, 05nr.350/02–147909/19/1 dt.02.07.2020, dokumentacionit të bashkangjitur, konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, dokumentin e planifikimit hapësinor – Plani Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim", në mënyrë kronologjike dhe procedurale, konstaton se:

Kërkuesit e lartë cekur me kërkesën 05nr.350/03 -147909/19 dt.27.06.2019, bashkangjitur kanë aplikuar ndër të tjerash edhe me dëshmitë e pronës për parcelat kadastrale nr.1802-1, 1802-2, 1802-3, 1802-5, 1802-9, 1802-11, 1802-14 & 1828-1 ZK Prishtinë, për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste - Ndërtesa "A", "B", "C" dhe "D", në kuadër të Bllokut Urban "F1" Tërësia "F" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë.



Kjo drejtori pas kontrollimi të dokumentacionit të prezantuar me projekt propozimin e prezantuar, ka konstatuar se për vazhdimin e procedurës, "zgjidhja urbane" duhet të i përfshi edhe disa parcela kadastrale, tjera që përfshihen brenda pjesës së bllokut urban, si dhe duhet të ndryshohet ri parcelimi i planit rregullues.

Pas këtij konstatimi, Investitori "Alwera Invest" sh.p.k. nga Ferizaj, konkretisht pronar i sajë, Arben Hasani nga Ferizaj, si përfaqësues edhe i pronarëve të parcelave kadastrale, me kërkesën 05nr.350/02 – 147909/19/1 dt.15.08.2019, ka kërkuar nga kjo drejtori, për pezullimin - shtyrje të afatit të vendosjes së çështjes administrative sipas kërkesës për caktimin e kushteve ndërtimore, 05nr.350/02 – 147909/19 dt.25.06.2019, për arsye të rregullimit të çështjeve pronësore-juridike të parcelave tjera, të cilën kërkesë kjo drejtori e ka miratuar me Vendimin 05 nr.350/02 – 147909/19/1 dt.19.08.2019;

Investitori, pas zhvillimit të procedurave të lartë cekura dhe rregullimit të parcelave, konkretisht pronësisë së tyre, ndarjes dhe bashkimit, me kërkesat-shkresat "Plotësim dokumentacioni" 05nr.350/02 – 147909/19/1 dt.09.03.2020, 05nr.350/02 – 147909/19/1 dt.02.07.2020, ka prezantuar dhe ka informuar Drejtorin e Urbanizimit, për rregullimin e çështjeve pronësore, duke prezantuar dëshmitë mbi pronësinë tani për parcelat kadastrale nr.10330-2 ZK Prishtinë, nr.10330-1, 10330-3 & 10330-5 ZK Prishtinë (me trajtim përmes transferimit - kompensimit me sipërfaqe ndërtimore), parcelat kadastrale nr.284-1 & 284-2 ZK Çagllavicë (me pronar Arben Hasani të destinuar në hapësira publike sipas dokumentit të planifikimit hapësinor) me trajtim përmes këmbimit me pjesën e parcelës kadastrale nr.1949-11 ZK Prishtinë, me pronar / poseduese P.SH. Rugët - KK Prishtinë, si dhe duke parceluar / ndarë parcelën kadastrale nr.10330-4 (me bashkëpronar, Arben Hasani, Agim Çavota, Rexhep Limani, Halit Beqa, Sabri Tërnavë, Bekim Zeqiri, Idriz Ferati, Lindita Jusufi, Ismet Maloku, Islam Rushiti, Hamide dhe Ymrije Rama, Sabri Hajdini, Hilmi Hajdini), për shkëmbim / ndërrim me parcelën kadastrale nr.10197-4 ZK Prishtinë (me bashkëpronar Nexhat Gashi, Ilir Fetahaj, Xhelil Ademi, Arben Dautaj, Fetah Fetahaj, Reshat Ademi, Isah Iseni, Fatime Hajrizi, Hamdi Kurteshi, Florim Grajçevci, Ali Aliu, Emin Hasani), sipas projekt propozimit / Plani i situacionit - "zgjidhjes urbane" të prezantuar, realizuar në dy faza ndërtimi / realizimi – Faza "1" & "2";

Pas kompletimit të dosjeve të lëndës, kjo drejtori ka marrë sërish në rishqyrtim në dokumentacionin e bashkargjitur, dhe ka përgatitur aktin administrativ të kushteve ndërtimore, ku dhe janë përcaktuar kushtet dhe kriteret për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin **Kompleksi "Alwera"** me ndërtesa shumë banesore & afariste – Ndërtesat, "A", "B", "C" & "D", duke përcaktuar edhe obligimet dhe kushtet para aplikimit për leje ndërtimore.

Pasi procedurat e përcaktuara në paragrafët VI. & VII., kërkojnë procedura kohore dhe miratim në Kuvendin e Komunës së Prishtinës (pjesa e këmbimit), kjo drejtori, Planin e situacionit – "zgjidhjen urbane" e ka nda në dy faza, **Faza "1"** me përfshirje të Ndërtesave, "A", "B" & "C" dhe **Faza "2"** me përfshirje të Ndërtesës, "D", sipas të cilës zgjidhje, kërkuessit pas pajësjes me kushte ndërtimore mund të aplikojnë për leje ndërtimi për Faza "1", kurse për Faza "2" pas zhvillimit të procedurës së paraparë në paragrafin VI. /Këmbimi/, VII./Ndërrimi-shkëmbimi/ dhe bashkimit të gjitha parcelave brenda vijës rregulluese;

Gjithashtu, në fazën fillestare të trajtimit të kërkesës me projekt propozimin e prezantuar, është konstatuar se në brendësi të kësaj pjesë të bllokut urban shtrihen edhe parcelat kadastrale nr.1802-6 dhe 1802-15 ZK Prishtinë, si dhe një pjesë e parcelës kadastrale nr.1802-4 ZK Prishtinë. Andaj kjo drejtori përmes shkresave "Ftesë" të datave 18.02.2020 (hera e parë) dhe 27.02.2020 (hera e dytë), ka ftuar pronarët e parcelave kadastrale të lartë cekura, Nehat Rexhepaj dhe Raif Morina, ku në shkresa të njëjtit i ka informuar me synimet e fqinjëve të tyre dhe i ka ftuar që me datë 26.02.2020 (hera e parë) dhe 04.03.2020 (hera e dytë), që në ora 10,00h në zyrën nr.6 të Drejtorisë së Urbanizimit të Komunës së Prishtinës, rr. "Radovan Zogoviq" nr.1, të marrin pjesë në procedimin administrativ, gjegjësisht trajtimin e projekt propozimit të prezantuar me kërkesën 05nr.350/02 -147909/19 dt.25.06.2019, të kërkuessve / pronarëve, Arben Hasani, Agim Çavota, Halit Beqa, Sabri Tërnavë, Bekim Zeqiri, Idriz Ferati, Lindita Jusufi, Ismet Maloku, Islam Rushiti, Hamide dhe Ymrije Rama, Sabri Hajdini, Hilmi Hajdini nga Prishtina



dhe Investitorit "Alwera Invest" sh.p.k. nga Ferizaj, me certifikatë të biznesit 81127999 dhe pronar Arben Hasani nga Ferizaj, kërkesë kjo për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor /projektin kryesor për ndërtimin e Kompleksi "Alwera" me ndërtesa shumë banesore & afariste – Ndërtesat, "A", "B", "C" & "D" në kuadër të Parcelave ndërtimore "F-1-1" dhe "F-1-2" të Bllokut urban "F-1" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të kompleksit formuar nga parcelat, nr.1802-1,1802-2,1802-3,1802-5,1802-7,1802-8,1802-9,1802-10,1802-11,1802-12,1802-14,1828 & 1949-11 ZK Prishtinë. Njëherë, të lartcekurit paraprakisht janë informuar edhe nga përfaqësuesi i Investitorit "Alwera Invest" sh.p.k. nga Ferizaj, z.Arben Hasani(bazuar në deklaratën gojore të ti), por të njëjti nuk kanë shprehur gatishmëri për kyçje në zgjidhje urbane dhe në ndërtim;

Në ditën dhe orën e caktuar me ftesa, në takim janë prezantuar vetëm investitori dhe projektuesi i projekt propozimit konceptual, kurse pronarët e parcelave të lartë cekura për të cilët edhe është organizuar takimi, nuk janë paraqitur e as pranuar ftesat, me që rast edhe janë mbajtur procesverbalet dhe i nënshkruar nga të pranishmit.

Bazuar në analizën e planit të situacionit, në raport me planin rregullues, konstatohet se në pjesa e parcelës kadastrale nr.1949-11 ZK Prishtinë, me pronar / poseduese P.SH. Rrugët - KK Prishtinë, përfshihet brenda bllokut urban - parcelës ndërtimore e cila pjesë bazuar në "Ligjin nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës" dhe vlerësimin e organit kompetent do të këmbehet me pjesë të parcelave kadastrale private, nr.284-1 & 284-2 ZK Çagllavicë, të cilat do të këmbehen dhe e njëjta të trajtohet në ndërtim.

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit – ekspertit për komunikacion, janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kyçje të kompleksit me rrugën e brendshme të bllokut, në rrugët e planifikuara të planit rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinës, ku ndër të tjera konstatohet :

*Pas shikimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Alwera Invest shpk., Sabri Ternava, Islam Rushiti, Hamide e Ymrije Rama, Ismet Maloku, Idriz Ferati, Agim Çatova, Halit Beqa, Bekim Zeqiri, Lindita Jusufi Prishtina e re, Zona Qendër, Prishtinë, lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës 05-350/02-147909/19 dt.25.06.2019, kyçja për automjete në rrugë të planifikuara për ndërtesën A me etazhitet 4B+2S+P+14+Ph, ndërtesën B me etazhitet 3B+2S+P+13+Ph, ndërtesën C me etazhitet 3B+2S+P+13+Ph, ndërtesën D me etazhitet 2B+S+P+12+Ph, mund të pranohet si e till, marr parasysh kategorinë e rrugëve të planifikuara, hapësirën e zgjidhjes urbane dhe shmangien e kyçjeve në raport me udhëkryqet e rrugëve të planifikuara. Në fazat e ardhshme të projektimit dhe realizimit të ndërtesave banesore me afarizëm për rampa dhe vend parkime, duhet të aplikohen kriteret sipas "Rregullores për Normat Teknike për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi", dhe të arrihen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjeve. Gjerësia e rrugëve kaluese me qarkullim dy kahor përgjatë hapësirave të vend parkimeve të jashtme dhe të brendshme në garazha, duhet të jetë minimum 5.5m. Ndryshime në rrugë të planifikuara sa i përket regjimit të trafikut me qëllim të favorizimit të ndërtesave banimore afariste nuk duhet të ketë. Kyçjet duhet të harmonizohen dhe të përshtaten me profilin e rrugëve të planifikuara edhe në kohën kur realizohen ato.*

Andaj si konkludim përfundimtar, bazuar në konstatimet e më sipërme, dokumentacionin e prezantuar dhe shqyrtuar, konsultimin e rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësiror Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt.31.05.2012, nenit 13 të "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", Ligjit 06/L-092 dt.07.03.2019, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe diskercionin për vendose të çështjeve të planifikimit dhe ndërtimit në bazë të nenit 4, 21 & 44 të LPPA-së Nr.05/L - 031 dt.21.07.2016, lidhur me ligjshmërinë për caktimin e kushteve ndërtimore, Drejtoria e Urbanizmit vendosi që ta miratoj kërkesën për caktimin e kushteve ndërtimore, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e **Kompleksi "Alwera"** me ndërtesa shumë banesore & afariste – **Ndërtesa, "A", "B", "C" & "D"** në kuadër të Parcelave ndërtimore "F-1-1" & "F-1-2" të Bllokut urban "F-1" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë, konkretisht parcelës kadastrale, nr.10330-2 ZK



Prishtinë, me trajtim përmes transferimit - kompensimit me sipërfaqe ndërtimore, të parcelave kadastrale, nr.10330-1, 10330-3 & 10330-5 ZK Prishtinë, me trajtim përmes këmbimit të parcelave kadastrale nr.284-1 & 284-2 ZK Çagllavicë (me pronar Arben Hasani) me pjesën e parcelës kadastrale nr.1949-11 ZK Prishtinë, me pronar / poseduese P.SH. Rrugët - KK Prishtinë, si dhe duke llogaritur edhe ndërrimin / shkëmbimin e parcelës kadastrale, nr.10197-4 ZK Prishtinë (me bashkëpronar Nexhat Gashi, Ilir Fetahaj, Xheil Ademi, Arben Dautaj, Fetah Fetahaj, Reshat Ademi, Isah Iseni, Fatime Hajrizi, Hamdi Kurteshi, Florim Grajçevci, Ali Aliu, Emin Hasani) me parcelën kadastrale nr.10330-4 (me bashkëpronar, Arben Hasani, Agim Çavota, Rexhep Limani, Halit Beqa, Sabri Tërnavaj, Bekim Zeqiri, Idriz Ferati, Lindita Jusufi, Ismet Maloku, Islam Rushiti, Hamide dhe Ymrije Rama, Sabri Hajdini, Hilmi Hajdini), sipas projekt propozimit / Plani i situacionit - „zgjdhjes urbane” të prezantuar, realizuar në dy faza ndërtimi / realizimi – Faza “1” & “2”.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

Njëherë, përmes shkresës „Njoftim” 05nr.350/02- 147909/19 dt.09.07.2020, kjo drejtori vendositi njoftoj pronarët e parcelave: nr. 1802-6 & 1802-15 ZK Prishtinë, Nehat Rexhepaj dhe Raif Morina nga Prishtina.

**Shtojcë:** Plani i situacioni - “zgjdhja urbane” e Kompleksi “Alwera” me ndërtesa shumë banesore & afariste – Ndërtesat, “A”, “B”, “C” & “D” në kuadër të Parcelave ndërtimore “F-1-1” & “F-1-2” të Bilokut urban “F-1” të Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Perëndim” në Prishtinë; Situacioni i parcelave kadastrale në raport me rrugët e planifikuar, si dhe vijën ndërtimore & rregulluese nga Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Perëndim” në Prishtinë, në sistemin koordinativ KosovaREF 01; Manuali i ndarjes dhe bashkimit të parcelave kadastrale.

**Udhëzim juridik:** Pala e pakënaqur me vendimin e kushteve ndërtimore, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtyre kushteve ndërtimore. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MEA, Departamenti Ligjor i Ambientit.

**I dërgohet:** Kërkesave, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës, 05nr.350/02 – 147909/19 dt.25.06.2019.

**I dërgohet përmes postës elektronike:** Drejtorisë për Pronën, Drejtorisë për Kadastër, Drejtorisë për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR.350/02 – 147909/19 DT. 09.07.2020**

Zyrtari:  
Ergyn Hajredini








Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtinë Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : 1949-11

Zona kadastrale / Katastarska zona: Prishtinë Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 1000

Lloji i njësive kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcel MANUALI I BASHKIMIT




Rilevimi / Snimio Roland Merxha

(emri dhe mbiemri i gjeddit/kompanisë/ tite/ prezime gjeddit/kompanisë)

Nr i licencës / Br. licence 167

Nënskrimi / Potpis [Signature]

Data e rilevimit / Datum snimanja 06.07.2020



Aprovimi / Usvajao

(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ tite/ prezime službenog lica)

Nënskrimi / Potpis


Data e aprovimit / Datum usvajanja



Në bazë të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore, me nr.05nr.350/02-147909/19 të dt.09.07.2020, të lëshuara nga Drejtoria e Urbanizimit, e cila ka dhënë pëlqim për këmbimin e parcelës me nr. 1862-0,pronë private, ZK Çagllavic me pjesën e parcelës 1949-11, pronë P.Sh.Rrugët në ZK Prishtinë

Prona-Rruga, Private  
Zona Kadastrale: Çagllavicë  
Numri i parcelës: P-71914075-01862-0  
Sipërfaqja: 772m<sup>2</sup>  
Pronar: Arben Hasani  
Lagjja/Fshati: Çagllavicë  
Adresa: Rruga Nikollë Brankati  
Sipërfaqja për këmbim: 772 m<sup>2</sup>

P.Sh.Rrugët  
Zona Kadastrale:Prishtinë  
I.Numri i parcelës: P-71914075-01949-11  
Sipërfaqja: 8675m<sup>2</sup>  
Pronar: P.Sh.Rrugët  
Lagjja/Fshati: Veternik  
Adresa: Veternik  
Sipërfaqja për këmbim pjesë e parcelëse me nr.1949-11 me sip. sipas vlerësimit nga organet kompetente.



— -Prona, rrugë private.  
— -P.Sh. Rrugët  
Prishtinë, 05.01.2021


Punoi:  
Sokol Gashi -zyrtar për gjeodezi



Në bazë të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore, me nr.05nr.350/02-147909/19 të dt.09.07.2020, të lëshuara nga Drejtoria e Urbanizmit, e cila ka dhënë pëlqim për këmbimin e parcelës me nr. 1862-0,pronë private , ZK Çagllavic me pjesën e parcelës 1949-11, pronë P.Sh.Rrugët në ZK Prishtinë

Prona-Rrugë, Private  
Zona Kadastrale: Çagllavicë  
Numri i parcelës: P-71914075-01862-0  
Sipërfaqja: 772m<sup>2</sup>  
Pronar: Arben Hasani  
Lagjja/Fshati: Çagllavicë  
Adresa: Rrugë Nikollë Brankati  
Sipërfaqja për këmbim: 772 m<sup>2</sup>

P.Sh.Rrugët  
Zona Kadastrale:Prishtinë  
1.Numri i parcelës: P-71914075-01949-11  
Sipërfaqja: 8675m<sup>2</sup>  
Pronar: P.Sh.Rrugët  
Lagjja/Fshati: Veternik  
Adresa: Veternik  
Sipërfaqja për këmbim pjesë e parcelës me nr.1949-11 me sip. sipas vlersimit nga organet kompetente.



■ -Prona, rrugë private.  
■ -P.Sh. Rrugët  
Prishtinë, 05.01.2021

Punoi:  
Sokol Gashi -zyrtar për gjeodezi





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

### CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71914075-01862-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:  
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:  
Komuna / Opština / Municipality:  
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:  
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:


011-940/01-0202581/20m  
03.11.2020 - 13:31  
Prishtinë / Prishtina / Prishtine  
ÇAGLLAVIÇE / ÇAGLLAVICA / ÇAGLLAVIÇE  
Prishtinë / Prishtina / Prishtine

### A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Pershkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-71914075-01862-0	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë private / Privately owned Land	Rural	772	12-2001, 11-2001, R.F.P.292/2020	03.11.2020	03.11.2020

### A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prehivalisite - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address Details	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
SILLATINA - TE SHELQJETSILLATINA - TE SHELQJETSILLATINA - TE SHELQJET		SILLATINA - TE SHELQJETSILLATINA - TE SHELQJET	03.11.2020	03.11.2020





**A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE**

Numri i/roj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës / Vrsta koriscenja parcelle / Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës / Trenutno koriscenje parcelle / Parcel Current Use	Kualiteti i klases / Kvalitet klase / Quality Class	Sipërfaqja e (m <sup>2</sup> ) / (m <sup>2</sup> ) / (m <sup>2</sup> )
1	Infrastruktura/Infrastruktura/Infrastructure	Krugë/Rrë/Road	Arë E Klases 4/Njiva 4 Klase/4th Class Arable Land	400
1	Bujqësore/Pojopjivredho/Agriculture	Arat/Njive/Arable		



**B. PRONARI/POSEDUESI - VLAŠNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR**

Të drejtat / Prava / Rights	Emri / Ime / Name	Nr. personal / Licni broj / ID. No.	Vendbanimi / Prebivaliste / Resident	Kodi postar / Poštanski kod / Postal code	Hollësitë e adresës / Pojednostoi adrese / Address details	Pjesa e pronës / Deo imovine / Share quota	Pershkrimi / Opis / Description	Azhuruar / Azurirano / Updated
Poseidim individual / Individualna Drzavina / single possessor	HASANI ARBEN	1011581559	TALINOVC I JERLIVE / TALINOVC I JERLIVE / TALINOVC I JERLIVE /			1/1	32/2020 AKTV I Z.K.K.NR.011 -463-2/356 DT.11.02.2020	03.11.2020





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PRISHTINË  
 Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Çagllavicë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup>
P-71914075-01862-0	Parcelë / Parcela / Parcel	772



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1089

Punoi/Obradio/Created:  
 Data/ Data/Date: 03.11.2020  
 Koha/ Vreme/ Time: 01:58:41  
 Nënshkrimi/Potpis/Signature:  
 Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature: [Signature]







REPUBLIKA E KOSOVËS \ REPUBLIKA KOSOVA \ REPUBLIC OF KOSOVO  
 QEVERIA E KOSOVËS \ VLADA KOSOVA \ GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT \ MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE I MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS \ KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA \ CADASTRAL AGENCY

KOPIJA E PLANIT \ KOPJA PLANA \ COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale \ Opštinska \ Katsatrska Kancelarija \ Municipal \ Cadastral Office : PRISHTINE  
 Zona Kadastrale \ Katsatrska Zona \ Cadastral Zone : Qajllavioë

Parcelë / Parcela / Parcel	Tipi \ Vrsta \ Type	Nivësi \ Jediniça \ Unit
P-71914075-01862-0	772	



Shkalla \ Razmëri \ Scale: 1:1089



Nëshkrimi \ Përkrahje \ Signature:  
 Aprobim \ Vërtetim \ Approval

Shënim \ Bemërkim \ Note:  
 Nënshkrimi \ Përkrahje \ Signature:  
 Kohë \ Vlerë \ Time: 07:58:41  
 Data \ Datë \ Date: 03.11.2020  
 Punë \ Objekt \ Created:





Republika e Kosovës  
Republica Kosovo-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

### CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71914059-01949-11

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 011-942-03-0001957/21  
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 08.01.2021 - 15:27  
Komuna / Opština / Municipality: Prishtinë / Prishtina / Prishtine  
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: PRISHTINË / PRISHTINA / PRISHTINE  
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: Prishtinë / Prishtina / Prishtine

#### A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R C/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-71914059-01949-11	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shtetërore / Drushtvena Inovina Socially owned Land	Urban	8675	R.F.P.125 2017.R.F.P.34 2019	13.02.2019	

#### A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostni adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
VETERNIK VETERNIK VETERNIK		VETERNIK VETERNIK VETERNIK	13.02.2019	



**A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE**

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kualiteti klase Quality Class	Sipërfaqja (m <sup>2</sup> ) Površina (m <sup>2</sup> ) Area (m <sup>2</sup> )
1	Infrastruktura/Infrastruktura Infrastructure	Rrugë E Pakarigor/Ne-kategorisami Puri/Une-ægorizet/Road		8675

**B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR**

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prehivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim Individual / Individuálna Drzavna / single possessor	P.SH RUGËT	KCID1914679	PRISHTINË, PRISHTINA PRISHTINË			1/1		14.02.2019





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PRISHTINË  
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Prishtinë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	*Sipërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup>
P-71914059-01949-11	Parcelë / Parcela / Parcel	8675



Shkalla/Razmera/Scale: 1:3332

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 11.01.2021

Koha/ Vreme/ Time: 09:26:39

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoui/Usvojioi/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:








KOPIJA E PLANIT \ KOPIJA PLANA \ COPY PLAN

Zyrtar Kadastrale Komunal / Opštinska Katastrarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office : PRISHTINE  
 Zona Kadastrale / Katastrarska Zona / Cadastral Zone : Prishtinë

Njësia Administrative / Unit	Parcela / Parcel	Tipi i Statusit / Type	Sipërfaqja Përafshirë / Area m <sup>2</sup>
P-71914059-01949-11			8675



Skallë / Razmëri / Scale: 1:3382



Nënskrimin / Pospis / Signature: \_\_\_\_\_  
 Dëshmitar / Witness: \_\_\_\_\_  
 Aprobim / Approval: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_


Shënime / Remarks / Note:  
 Kohë / Time: 09:26:39  
 Data / Date: 11.01.2021  
 Punojtë / Created:





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opstina Pristina - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2 pika d dhe të nenit 17, pika b e Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/ 15, qershor 2008), të dispozitave të Ligjit nr. 04/L-174 për planifikim hapësinor, të nenit 15, paragrafi 15.1, pika b dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2013, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES URBAN**  
**"PRISHTINA E RE - PERENDIM" NË PRISHTINË**

**I.**

1. Miratohet Plani rregullues urban "Prishtina e Re - Perendim" në Prishtinë.
2. Plani nga paragrafi 1 i kësaj pike, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat paraqesin pjesë përbërëse të këtij vendimi dhe ka sipërfaqe prej 420 ha.

**II.**

Në bazë të planit të miratuar sipas këtij vendimi, do të caktohen kushtet e ndërtimit, sipas të cilave do të miratohet dokumentacioni që ka të bëjë me ndërtimin, sipas destinimit të shfrytëzimit të tokës të parcelave ndërtimore brenda kufijve të këtij plani.

**III.**

Kushtet e ndërtimit, sipas pikës II të këtij vendimi, do të përcaktohen nga organi kompetent i Komunës së Prishtinës për punë të urbanizmit, në baze të kriterëve të përcaktuar me këtë plan rregullues urban, ligjeve dhe akteve tjera nënligjore në fuqi gjatë zbatimit të këtij plani.

**IV.**

1. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës.



2. Organet tjera kompetente të Komunës do t'i kryejnë veprimet procedurale nga përgjegjësitë e tyre të caktuara me ligj për zbatimin e këtij plani.

V.

Ky vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljes së Komunës dhe në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

01. nr 035-186850, më 02.10.2013

**KRYESUESI I KUVENDIT**

Sami Hamiti, ecc. i dipl.

